



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**Thirrje e rishpallur për aplikim për pjesëmarrje në stendën shtetëror të Kosovës  
në panairin "GITEX Europe 2025" në Berlin/Gjermani**

Data e organizimit:

21-23 maj 2025

Adresa: Berlin, Gjermani

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të teknologjisë informative dhe komunikimit dhe startup, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës, regjistrimin e 5 subjekteve pjesëmarrëse [ 1 prej tyre startup ( e themeluar 1-5 vjetet e fundit)] nga sektori e teknologjisë informative dhe komunikimit dhe startup, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 12.05.2025. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirrologarisë aktive në njëren prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 5 subjekte:

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
  - 1 pikë për 1 produkt
  - 3 pikë për 2 produkte
  - 5 pikë për 3 produkte
  - 7 pikë për 4 produkte dhe
  - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 5 pikë
  - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 4 pikë
  - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2024, maksimum 10 pikë:
  - Shtetet e BE-së 5 pikë
  - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
  - Shtetet tjera 2 pikë.

Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- ISO 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
  - 1 deri në 3 panair 3 pikë dhe
  - 4 deri në 6 panair 5 pikë.
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024, maksimumi 10 pikë:
  - 0 - 500.000 euro 4 pikë
  - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
  - > 1,000.000 euro 10 pikë.
- Për kompanitë Start-up, qarkullimi i subjektit aplikues në vitin 2024, maksimumi 10 pikë:
  - 0 - 50.00 euro 4 pikë
  - 50.01 – 5,000 euro 8 pikë dhe
  - > 5,000 euro 10 pikë;

Më 12.05.2025, në ora 09:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashkë me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 12.05.2025 në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit: [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) apo në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)